

Ismet BEQIRAJ



Datëlindja:10.05.1958

Vendlindja: Mollaj

Email:Ismet.Beqiraj@parlament.al

Jetëshkrimi:

Ismet Beqiraj ka përfunduar studimet pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës, Dega Kimi Industriale, duke marrë titullin “Kimist Industrial” (1982-1987).

Gjatë perjudhës (2002-2004) ka kryer Shkollën Pasuniversitare (SHPU), pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës.

Ka një karrierë të pasur politike, i zgjedhur në forumet e PS të rrethit, të bashkisë dhe në qendër. Kryetar i PS të rrethit Mallakastër (1991-1992). Gjithashtu, Beqiraj ka qenë anëtar i Komitetit Drejtues dhe i Kryesisë së PS të rrethit Mallakastër, për vitet (1991-2001).

Në vitet 1991 -1994 ka qenë anëtar i KPD. Më pas, ai është zgjedhur si sekretar i KZ të PS në njësinë bashkiake nr. 5, Tiranë, 2004-2007. Aktualisht anëtar i Asamblesë NJB Nr. 5 dhe delegat i Kongresit të PSSH deri në vitin 2015. Beqiraj ka një eksperiencë të pasur si teknolog naftë, inxhinier, inspektor, këshilltar dhe pedagog.

Për dy vite ka punuar si inxhinier reparti në kompaninë e shtetërore të naftës "ARMO" sh.a Fier, në Impiantin e Hidropastrimit, në KPTHN, Ballsh. Nga 2006–2008 ka punuar si pedagog i jashtëm në Departamentin e Kimisë dhe Kimisë Industriale dhe Mjedisore, pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Tiranë.

Prej 2008 punon si pedagog definitiv në grup-seksionin e “Teknologjisë Kimike Organike, pranë Departamentit të Kimisë Industriale dhe Mjedisore në Fakultetin e Shkencave Natyrore, Universiteti i Tiranës.

Ka marrë Gradën “Doktor i Shkencave në Kimi”, më 28 Mars 2008 si dhe Titullin Akademik “Profesor i Asociuar”, më 1 qershor 2012. Beqiraj ka kryer një sërë kualifikimesh dhe trajnimesh, brenda dhe jashtë vendit.